- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Veç kësaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet të dorëzohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Përshkrimin e Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratë për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1;*
- c. *Sigurimoferte, (nëse është zbatueshme) sipas Shtojcës 3;*
- ç. *Deklaratëmbi përmbushjen e Specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- d. *Deklaratëmbi Konfliktin e Interesit sipas Shtojcës 7;*
- dh. *Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës Shtojcës 8/1;*
- e. *Formular vlerësimi sipas Shtojcës 9;*
- f. *Deklaratëmbi disponueshmërinë e mjeteve sipas Shtojcës 10;*
- g. *Deklaratë mbi kontratat e lidhura apo ne proces, sipas Shtojcës 11;*
- gj. *Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë:

Sipas Kriteve te pergjithshme të Pranim/Kualifikimit, pika 1 e shtojcës 12

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1- Vlera mesatare e xhiros së realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit të jete jo më e vogël se 50 % e vlerës së fondit limit që prokurohet.

Në plotësimin e kësaj pike operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vertetim nga Dega e Tatim-Taksave per xhiron gjate tre viteve të fundit (2017, 2018 dhe 2019)
- b) Kopje te certifikuara te bilanceve për tre vitet e fundit (2017, 2018 dhe 2019).
- c) Vertetim te shlyerjes se detyrimeve vendore per vitin 2019 dhe 2020 në të gjitha adresat ku operatori/operatoret ekonomik ushtrojne aktivitetin e tyre sipas te dhenave perkatese te ekstraktit te QKB-se.

2.3 Per kapacitetin teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a) Punë të ngjashme e realizuar ne një kontrate te vetme me vlerë sa 50% e vlerës së fondit limit, te realizuar gjatë tri viteve të fundit **,ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.**

ose

- b) punë të ngjashme deri ne nje kufi ku vlera monetare totale e kontratave te punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë

sa dyfishi i e vleres se fondit limit dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, **ku zerat e punimeve respektive plotesojne kriteret minimale te preventivit te objektit ne prokurim.**

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

2.3.1/a Për kontrata të realizuara me autoritete publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
2. Kontratë
3. Situacionin përfundimtar;
4. Aktin e kolaudimit;
5. Faturat perkatese tatimore e situacionit përfundimtar

2.3.1/b Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9/ ose Reference Punimesh:
2. Kontrate;
3. Situacionin përfundimtar;
4. Akt kolaudimi objekti;
5. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

3.Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës.

Operatorët ekonomik duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kobntrates .Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008: **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”**.Liçenca e shoqërisë duhet të jetë vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

a. Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- N.P -1 B** Punime gërmimi në tokë.
- N.P -3 B** Rikonstruksion dhe mirëmbajtje.
- N.P- 4 B** Rrugë autostrada, mbikalime
- N.P- 5 A** Punime nentokesore, ura e vepra arti
- N.P -12A** Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S – 6 A** Sinjalistika rrugore jodriçuese
- N.S - 7A** Ndertime parafabrikat beton arme
- N.S - 8A** Barriera dhe mbrojtje rrugore
- N.S – 10 B** Shtresa dhe mbistruktura infrast,
- N.S – 18A** Punime topogjeodezike.
- N.S – 19A** Sistemet kundra zhurmes per infrastrukture

Dokumenta Standarde të Tenderit

Për Operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (Ish Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit), në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës

4. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimum 10 (dhjetë) vjet.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarime të reme do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma a, të Ligjit 9643, dt 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimet Publike”

4. Një punësim mesatar i të paktën **100 (njëqind)** personave, për periudhën 6(gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit të vërtetuar me;

4.1 Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; për periudhën 6(gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit .

4.2 List pagesat e kofirmuara të punonjësve sipas formatit që kërkohej nga legjislacioni në fuqi për periudhën 6(gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit , shoqëruar me formularët e deklaratimit të pagesave FDP për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore si dhe urdherxhirimet e pagesave në bankë për secilin muaj të kësaj periudhe.

5. Operatorët ekonomike pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre punonjës të mëposhtem, të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashte) muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, libreze pune.

- Inxhinier Ndertimi 2 (dy)
- Inxhinier Elektrik 2 (dy)
- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 2 (dy)
- Inxhinier Hidroteknik 2(dy)
- Inxhinier Topograf/Markshejder 2 (dy)
- Inxhinier Gjeolog 1(një)
- Arkitekt 1(një)

Dokumenta Standarde të Tenderit

5.1 Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë te pakten **45 (dyzetë)** punonjës (perfshi Stafin Teknik te perfshire ne licencen e shoqerise), të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, ku nga te cilet jene te pakten:

- 2 Teknik Ndertimi (vertetuar dhe me diplome)
- 2 Elektracist
- 2 Murator
- 1 Pllakashtrues
- 2 Karpentier
- 2 Hekurkthyes
- 2 Mekanik
- 2 Teknik Gjeometer
- 12 Specialist te ndryshem ndertimi

Për keta punonjes, ofertuesi duhet të paraqesë:

- kontratën individuale të punës;
- një dokument (deshmi/certifikate te kualifikimit te sigurimit teknik), që të vërtetojë kualifikimin profesional të mësipërm);

5.2 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet te kenë të punësuar si staf mbështetës për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, me dëshmi kualifikimi profesional nga subjektet e akredituar, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit stafi si më poshtë:

- 2 (dy) specialist per montim tubash
- 1 (nje) hidraulik
- 1 (një) saldator
- 1 (një) elektracist

- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht **15(pesembedhjetë)** punonjës manovratorë te mjeteve te renda, nga cilet te jene minimalisht keto profesione **Automakinist dhe eskavatorist dhe Buldozerist**. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, lejen e drejtimit (të vlefshme), Dëshmine e Aftesise Profesioale D.A.P (te vlefshme) dhe/ose Certifikata e Aftesimit Profesional (C.A.P), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.*

5.3 Operatori duhet te kete ne staf te punësuar:

- a. 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e drejtuesve Teknik te shoqerise duhet te jete i certifikuar si "*Përgjegjës për mbrojtjen dhe administrimin e dëmtimit të mjedisit*", e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Dokumenta Standarde të Tenderit

(Për ekspertin e Demit ne Mjedis duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te paktën 6 (gjashte) muajt e fundit.

- b. 1(një) nga inxhinieret e siperkerkuar, duhet te jene te pajisur me certifikaten te Trajnimit për *"Pergjegjes per sigurimin dhe kontrollin e cilesise sipas ISO 9001:2015"*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

(Për pergjegjesin e kontrollit te cilesise duhet te paraqitet Certifikata perkatese si dhe Kontrata e punes e vlefshme si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te paktën 6 (gjashte) muajt e fundit.

- c. 1(një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për *"Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"*, *"Pergjegjes per sigurine"*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi kete certifikate).
- d. 1(një) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për *"Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier"*, *"Pergjegjes per sigurine"*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi kete certifikate).
- e. Operatori ekonomik duhet te ketë në stafin e tij, 2(dy) person te certifikuar per *"Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave"*, i cili duhet te figuroje ne listepagese minimalisht per 6 muajt e fundit. (Ne rastin e bashkimit te operatoreve secili operator duhet te paraqesi kete certifikate).

5.4. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet te jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit. (Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomikë, secili prej operatoreve duhet të ketë 1 mjek ndërmarrjeje. Mjeku duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën për 6 (gjashte) muajt e fundit.

6. Operatori Ekonomik duhet te jete i licensuar nga QKB me Licence III.2.A(1+2) "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis" - Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin ne mjedis.
7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Leje Mjedisore **Tip C** lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licensimit për stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme (**Kodi III.1.A**) /ose Operatori ekonomik pjesemarres duhet të këtë kontratë noteriale per depozitimimin e nbetjeve jo të rrezikshme me një subjekt te licensuar nga ana e QKL.

8. Çertifikatat e Cilësisë:

Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të certifikuar dhe të paraqesin çertifikatat e cilësisë së punimeve sipas objektit të prokurimit, si me poshte :

- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 9001:2015 (per sistemin e menaxhimit te cilesise)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 14001:2015 (per sistemin e menaxhimit te mjedisit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **OHSAS 18001:2007 (per sistemin e menaxhimit te shendetit dhe sigurise ne pune)**, ose cetifikaten **ISO 45001-2018** ekuivalente, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **BS ISO 39001:2012 (per sistemin e menaxhimit te sigurise ne trafikun rrugor)** e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **SA 8000:2014 (per sistemin e menaxhimit te pergjegjesise shoqerore)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO/IEC 27001:2013 (per sistemin e menaxhimit te sigurise se informacionit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 50001:2011 (per sistemin e menaxhimit te energjise)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **EN-ISO 3834 -2:2006 (per kerkesat e cilesise per saldimin e materialeve metalike)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **DS CEN/TR 15128:2005 (per standartet europiane per riparimin e sistemeve te kanalizimit dhe kullimit)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **ISO 1452-1:2009 (per sistemin e tubacioneve plastike per f. me uje, kullimet dhe kanalizimet nentokesore dhe mbitokesore)**, e vlefshme,
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit **BS EN 13331-1:2002 (per sistemin e veshjes se kanaleve)**, e vlefshme,

(Çertifikatat qe do te paraqiten kerkohen te jete e vlefshme ne kohen e zhvillimit te tenderit, si dhe te jene leshuar nga institucionet zyrtare te akredituar per kete qellim;

Ne rastin e bashkimit te perkohshem te shoqerive secili operator duhet te paraqese certifikatat e mesiperme, ne varesi te punimeve qe do te marri persiper konform marreveshjes.)

a). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, ISO 39001 - 2012, PAS 99: 2012 dhe QKL perkatese perfshi Lejet perkatese qe duhen marre per keto impiante** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Inerte, – Betone,**

b). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, shoqeruar me certifikatat e konformitetit/performances sipas HRN 1130-2:2008 dhe EN 10080:2012 dhe TS 708:2010** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Hekur,**

c). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015 dhe Kataloget perkates te produkteve** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Materialet Elektrike**

d). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, ISO 39001:2012, ISO 45001:2018, PAS 99:2012 dhe Kataloget perkates te produkteve** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen:

-Bordura betoni, puseta betoni, tuba betoni, pllaka trotuari betoni etj.

f). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, ISO 18001-2007, ISO 14001-2015** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Materialet hidraulike - tubo, rakorderi etj.**

g). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, ISO 14001-2015 dhe QKL-te perkatese Licence III.7.A "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore baze", Licence II.4 "Prodhimi dhe/ose tregtimi i farave dhe/ose fidaneve", Licence III.2.A(1+2) "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin ne mjedis" - për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Materiale te Gjelberimit,****

Për plotësimin e pikave pika a,b,c,d,e,f,g,h operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkuara për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”

9. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (shtojca 9):

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 11(njëmbëdhjetë) ton dhe maksimumi 17(shtatëmbëdhjetë) ton për secilin kamion	4 copë	Pronësi ose me qera
Kamion (kapaciteti mbajtës minimum 3.5(tre pike pesë) ton dhe maksimumi 5(pesë) ton për secilin kamion	3 copë	Pronësi ose me qera

Dokumenta Standarde të Tenderit

Kamionçine (kapaciteti mbajtës minimum 1.5(nje pik pesë) ton dhe maksimumi 2(dy) ton për secilin kamionçinë	2 cope	Pronësi ose me qera
Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 (njetete) ton	2 copë	Pronësi ose me qera
Fadrome me goma	2 copë	Pronësi ose me qera
Eskavator me goma	3 copë	
Eskavator me zinxhire	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	2 copë	Pronësi ose me qera
Autopompe Betoni	1 copë	
Mini - eskavator/ fadrome	2 copë	Pronësi ose me qera
Telehender/Pirun	1 copë	Pronësi ose me qera
Autovinc	2 copë	Pronësi ose me qera
Autobot uji	2 copë	Pronësi ose me qera
Grejder	1 copë	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice/Mjet sperkates Bitumi	1 copë	Pronësi ose me qera
Rrul ngjeshes, vibrues	2 copë	Pronësi ose me qera
Asfalto prerese (share per asfalt)	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik Hidraulik	1 copë	Pronësi ose me qera
Skarifikues Asfalti	1 copë	Pronësi ose me qera
Vinc Karrel	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni te brendshem	2 copë	Pronësi ose me qera
Vibrator betoni te jashtem	2 copë	Pronësi ose me qera
Tokmak me karburant, per ngjeshje	2 copë	Pronësi ose me qera
Pllake vibruese	2 copë	Pronësi ose me qera
Pompe uji	1 copë	Pronësi ose me qera
Aparat gazogjen	1 copë	Pronësi ose me qera
Kompresor	1 copë	Pronësi ose me qera
Helikopter per lucidim, nivelues	2 copë	Pronësi ose me qera
Bot uji min.	1 copë	Pronësi ose me qera
Gjeneratore	2 copë	Pronësi ose me qera
Matrapik	4 copë	Pronësi ose me qera
Makine per ngjitje tubass	1 copë	Pronësi ose me qera
Kontenier, zyra te levizshme	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrik asfalti me QKL	1 copë	Pronësi ose me qera
Fabrikë prodhim Betoni dhe Nyje Inertesh Te pajisur me QKL perkatese	1 copë	Pronësi ose me qera ose furnizimi
Eskavator/Vinc krahe gjat mbi 30m, aftesi mbajtese mbi 40 ton	1 copë	Pronësi ose me qera

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 80 copë

Dokumenta Standarde të Tenderit

- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 7 copë
 - Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 copë
 - Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 10 copë
 - Uniforma pune 80cope
 - Jelek pune 80cope
 - Doreza pune 80cope
 - Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 40 copë
- a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik; d) siguracion mjeti, (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit (e vlefshme).*
- b) Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*
- a) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik, d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brënda vëndit për të tretë (e vlefshme).*
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- c) Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruar sipas shtojcës Nr. 10. (Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese).*
- d) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaroi se mjetet dhe pajisjet e deklaruar sipas shtojcës 10 nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk janë të deklaruar ne procedurat të shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor.*
10. **Grafiku i punimeve** në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.
11. Cdo ofertues duhet të paraqesë **Planorganizimin dhe Planin e Sigurisë në Kantier** për punimet në objekt sipas VKM nr 692 datë 13.12.2001 ”Për masat e vecanta të sigurimit dhe të ruajtjes së shëndetit në punë” i ndryshuar.
12. Operatori ekonomik/ofertuesi pjesëmarrës në tender së bashku me dorezimi e preventivit duhet të dorëzojë **analizat teknike** për të gjithë zërat e punimeve në preventivin të ofertës. (Referuar VKM Nr.514, datë 15.8.2007 Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve në ndërtim.

Në preventivin e punimeve objekt prokurimi në respektim të nenit 23 të LPP-së në të gjitha rastet kur përmendet “markë” pranohet termi “ose ekuivalent i tij/i saj.”

Dokumenta Standarde të Tenderit

Në specifikimet teknike objekt prokurimi në të gjitha rastet kur përmenden standartet EN pranohet termi sipas standartit SSH.

- *Të gjithë dokumentat që nuk janë lëshuar në Republiken e Shqipërisë duhet të jenë të legalizuara ose me vule apostile sipas legjislacionit përkatës.*
- *Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mosdorëzimit të një dokumenti, ose dorëzimit të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.*

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

Përshkrimi i të dhënave teknike tëpunëve objekt prokurimi të përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.

KUJDES

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Skicimet, Planimetritë e Objektit etj:

Specifikimet Teknike tëMaterialeve:

Grafiku i Punimeve: **6 muaj nga data e lidhjes se kontrates.**

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Shtojca 14

(Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti kontraktor)

PREVENTIV I PUNIMEVE**OBJEKTI: SISTEMIM ASFALTIM RRUGA " LLAPUSHAJ", GRAMSH.****Investitori: Bashkia Gramsh**

Nr.	Nr.An	Emërtimi	Njësia	Sasia	Cmimi	Vlera
I		Punime prishje Shpyllezimi				
1	2.426/5	Prishje mure betoni	m3	193		
2	3.3	Prerje pemesh Ø 10-20 cm	cope	263		
3	2.37/5a	Transport mbeturinash auto ÷ 5 km	m3	2150		
		SHUMA I				
II		Punime dherash ne rruge				
1	3.17	Germim dheu seksioni i lire me krah	m3	1654		
2	3.46/1	Germim kanali S=0.75 m2 me krah	m3	420		
3	3.87/a	Germim kanali eskavator 0.25 m3	m3	780		
4	3.124/4a	Germim shkemb i sek. Lire me eskavator	m3	385		
5	3.164/1	Rrafshim skarpate eskavator 0.5 m3	m2	2850		
6	3.25/a	Germim dheu themel	m3	1986		
7	3.179	Germim kasonete	m3	720		
8	An164/1a	Mbushje me material te germuar me makineri	m3	650		
		SHUMA II				
III		PUNIME SHITRESASH NE RRUGE				
1	An152	Vije zime shirita gjatesor 15 cm bokoponente	ml	1058		
2	3.617	F.V bordure betoni 15x25	ml	2116		
3	3.193/b	Shtrese zhavori lumi t=20cm me cilindrim	m2	5290		
4	3.210	Shtrese cakulli 15 cm i rruluar	m2	4232		
5	3.212/B	Shtrese stabilizanti 10 cm	m2	4232		
6	AN	Sperkatje emulsion bitum 1l/m2	m2	4232		
7	3.222/2	Shtresa binderi 6cm	m2	4232		
8	3.226/1	Shtrese asfaltobetoni 4 cm	m2	4232		
		SHUMA III				

Dokumenta Standarde të Tenderit

IV		PUNIME KANALIZIMI UJRA SHIU				
1	3.87/a	Germim dheu kanal	m3	720		
2	3.An/1t	Tuba te brinjezuar HDPE ø315	ml	536		
3	3.An/2t	Tuba te brinjezuar HDPE ø400	ml	355		
	3.An/3t	Tuba te brinjezuar HDPE ø500	ml	296		
	An-23	Puseta ujembledhese kapak gize 40x60x100	cope	60		
	2.261	Shtrese rere nen e mbi tuba 2x10cm	m3	190		
	3.243	Betonim kunete monolite C16/20	m3	52		
		SHUMA IV				
V		PUNIME K.U.Z				
	3.87/a	Gernim dheu kanal	m3	866		
	2.An-7	F.V tuba PVC f=315 mm te brinjezuar	ml	672		
	2.An-6	F.V tuba PVC f=250 mm te brinjezuar	ml	318		
	2.575	Puset kontrolli 1*1*1.5m	cope	22		
	2.261	Shtrese rere nen e mbi tuba 2x10cm	m3	65		
		SHUMA V				
VI		PUNIME MURE MBAJTES+PRITES				
	2.111/2	Mure mbajtes betoni M-200	m3	2056		
	2.111/2	Mure prites betoni M-200	m3	163		
	3.365	Tombino betoni ø 600	ml	16		
	2.166	F V hekur betoni periodik ø6-10 mm	ton	3.1		
	2.167	F V hekur betoni periodik ø>10 mm	ton	1.9		
	An	Kanal betoni me zgare metalike	ml	25		
		SHUMA VI				
VII		PUNIME TROTUARI				
	3.25/a	Germim dheu themel	m3	508		
	3.239	Betonim themel bordure M-100	m3	267		
	3.617	F.V bordure betoni 15x25	ml	1058		
	3.183/e	Shtrese zhavori 10 cm	m2	1268		
	3.62	Trotuar me 6 cm me pllaka betoni	m2	1268		
	An	Parmak metalik	ml	611		
		SHUMA VII				
VIII		PUNIME NDRICIMI				
	3.An/56	F.V shtylla ndricimi h=9m led me dy krahe perfshire te gjitha aksesoret e shtylles	cope	32		
	An	Tub plastik ø100 telefoni +elektrik	ml	2122		
	An	F.V kuader komandimi komplet me santeri + fotoelement	cope	1		
		SHUMA VIII				
IX		PUNIME GJELBERIMI				

Dokumenta Standarde të Tenderit

	An 164	F.V fidane peme dekorative	cope	178		
	3.244/1	Bordura betoni 6*12 per peme	m3	3.5		
	An	F.V minikosha mbeturinash	cope	25		
4						
		SHUMA III				
		SHUMA I + II + III				
		T.V.SH= 20%	%	20		
		SHUMA TOTALE				

Shtojca15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁵

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

⁵ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Dokumenta Standarde të Tenderit

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006Për Prokurimin Publik.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP-së.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt
<Emri>

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TËFITUESIT

[Data_____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Dokumenta Standarde të Tenderit

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimine kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006“Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____

2. _____

3. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj*]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatorën e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____

Dokumenta Standarde të Tenderit

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. ____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 18

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët – Procedura e Hapur

Neni 1: Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.

- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv per njesi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afatii realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikon për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontratore.
- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarte Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.
- 2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të perkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

- 3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.
- 3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

- 4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.
- 4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.
- 4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

- 5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.
- 5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

- 6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.
- 6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.
- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

